Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-456
Datë: 26.07.2023

Në mbështetje të nenit 4 dhe 23 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës nr. 03/L-189, nenit 6 dhe 16 të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare nr. 03/L-060, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë nr. 35/2014, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 19.07.2023 nxjerrë këtë:

VENDIM

1. **Akreditohet** Britannica ELT – Edmond Ramadani, rr. Imzot Nik Prela,Ulpiana Prishtinë , për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 19.07.2023 deri 18.07.2026, për të ofruar, vlerësuar dhe certifikuar këtë kualifikim:

   1.1 **Kurse të Gjuhës Angleze niveli A1 deri në C2 sipas KPERGJ-së.** Institucioni do të realizojë procesin e aftësimit për një vit kalendarik në total 68 grupe brenda vitit me 15 pjesëmarrës në grup.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së Britannica ELT – Edmond Ramadani, për akreditim dhe rekomandimeve të dala nga raporti i ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Në total shkolla mund të ofrojë kurse për 1020 nxënës në vit. Janë të angazhuar 6 mësimdhënës më orar të plotë x 8 grupe x 15 nxënës për grup = 720 nxënës, dhe 5 mësimdhëmës me gjysmë orari x 4 grupe x 15 nxënës për grup = 300 nxënës.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Britannica ELT – Edmond Ramadani
2. Arkivit të AKK.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK